



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 36 .

Prishtinë, më 28.3.2019, në ora 18:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Xhelal Sveçla, Danush Ademi zëvendëskryetarë të dytë, Fadil Beka, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica Shinik, Slobodan Petroviç. dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Igor Simiq, Kujtim Shala, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljeviq, Zoran Mojsilović dhe Duda Balje.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Zëvendëskryetari - Xhelal Sveçla, u shpreh se ky rendi i ditës është caktuar të shqyrtohet në procedurë të përshpejtuar, dhe bazuar në kompetencat tona si komision i përhershëm duhet të shqyrtohet çdo projektligj, ku më pas dalim me rekomandim të cilin e procedojmë në komisionet funksionale. Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

Zëvendëskryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pasi shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 18:45.

Përgatitur nga; Njësia mbështetëse e Komisionit

Zëvendëskryetar i Komisionit

Xhelal Sveçla